REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA MALIQ
KËSHILLI I BASHKISË

Nr 3408 Prot Maliq, më 01. 06. 2026

V E N D I M
Nr. 71, datë 29.05.2026

PËR MIRATIMIN NË PARIM PËR DHËNIEN NË PËRDORIM TË FONDIT PYJOR PËR NDËRTIMIN E KULLAVE EOLIKE NGA KOMPANIT "WP MORAVA" SHPK DHE ALBPOWER SHPK

Bazuar në : ligji nr. 139, datë 17.12.2015 "*Për Vetëqeverisjen vendore*", i ndryshuar, neni 54 "*Detyrat dhe kompetencat e këshillit bashkiak*", gërma "e/1", neni 55 "*Votimi*" pika 3, neni 64 "*Kompetencat dhe detyrat e kryetarit të bashkisë*", gërma "a"; ligj nr. 57/2020 "*Për pyjet*", neni 25; ligji nr.9693, datë 19.03.2007 "*Për fondin Kullosor*", i ndryshuar; Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 433 datë 08.06.2016 "*Për transferimin në pronësi të Bashkive të pyjeve dhe të kullotave publike...*", i ndryshuar; Urdhrit të Ministrit të Turizmit dhe Mjedisit nr. 299 datë 04.10.2022 "*Për miratimin e planeve të mbarështimit të ekonomive pyjore të Bashkisë Maliq*"; Udhëzimi nr.1, datë 09.06.2016 i Ministrit të Mjedisit "*Për rregullat, procedurat e kërkimit, të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënie në përdorim të fondit pyjor dhe kullosor publik*", pika 22, gërma "j"; Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 559 datë 29.07.2022 "*Për përcaktimin e çmimeve dhe tarifave për dhënien në përdorim të fondit pyjor/kullosor*", shtojca 1, pika 8; Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.467 datë 31.07.2025 "*Për miratimin e tarifave të përdorimit të kullotave dhe livadheve për kullotje ose kositje, për veprimtari shoqërore, shëndetësore, sportive e turistike dhe për prodhimin e energjisë së rinovueshme*",shtojca nr.3; Kërkesës së subjektit nr. 32 prot, datë 06.01.2026 dhe nr. 33 prot datë 06.01.2026; Këshilli i Bashkisë:

VENDOSI:

1. Miratimin në parim për dhënien në përdorim të sipërfaqeve nga fondit pyjor që preken nga ndërtimi i aerogjeneratorëve nga kompanit "WP Morava" shpk dhe Alpower shpk.
2. Të ngrihet grupi i punës për të verifikuar në terren sipërfaqen që preket nga ky aktivitet dhe në planet e mbarështimit të verifikohen të dhënat kadastrale.
3. Në bazë të verifikimit të kryer të hartohet raporti teknik-ekonomik për sipërfaqen që do të jepet në përdorim me kontratë qiraje.
4. Në raporti tekniko-ekonomik do të përcaktohet vlera e kontratës së qirasë.
5. Subjektet "WP Morava" shpk.dhe Albpower shpk gjatë zbatimit të projektit për ndërtimin e aerogjeneratorëve të mos përdorë metoda me lëndë plasëse apo shpërthime.
6. Gjatë zbatimit të projektit për ndërtimi i kullave eolike në fshatrat Zëmblak dhe Plasë të parashikohen nga subjekti investime në shërbim të komunitetit .
7. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi Bashkia Maliq nxjerr certifikatat e pronësisë të ngastrave që do jepen në përdorim dhe lidh kontratën e qirasë.
8. Për zbatimin e këtij Vendimi ngarkohet Sektori i Pyjeve dhe Kullotave në bashki.
9. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6, nenit 55, të ligjit nr. 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore" i ndryshuar.

Miratuar me 18 vota
Vota pro 18
Vota kundër 0
Vota apstenim 0
Zbardhur më datë 01.06.2026

KRYETARI I KËSHILLIT
Ornildi DEMOLLARI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË – BASHKIA MALIQ